



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: z. Bashkim Ramosaj, Kryetar

Adresa: Rr. " Jashar SALIHU " / Nr.3, Deçan, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Deçanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Deçanit (KD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Deçanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Vlera e pasurive e prezantuar në PVF nuk ishte e saktë dhe e plotë pasi që pasurit kapitale mbi 1,000€ ishin nënvlerësuar për 1,829,886€, ndërsa në anën tjetër ishin mbivlerësuar për 327,275€. Po ashtu vlera e pasurisë jokapitale nën 1,000€ ishte nënvlerësuar për 115,209€.
- B2 Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 70,000€ në kategori ekonomike jo adekuate

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Deçanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Deçanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B3 Komuna gjatë vitit 2020 kishte kryer pagesa në vlerë prej 1,694,096€ apo 1,375 raste të pagesave të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor.
- A1 Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë
- B4 Tek kontrata kornizë "Mirëmbajtje verore dhe dimërore në rrugët e komunës së Deçanit" ka pasur tejkallim të sasisë së kontraktuar në vlerë 282,209€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Deçanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Deçanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve

financiare të Komunës së Deçanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Deçanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Deçanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe


në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mos prezantim i plote dhe i saktë i pasurisë kapitale dhe jokapitale

Gjetja

Neni 6.1 i Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare kërkon që: “çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Po ashtu, sipas nenit 6.3: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria”. Më tutje, neni 22 pika 1 përcakton që zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtvizore. Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. Sipas nenit 6 pika 2 të së njëjtës rregulloreje çdo organizatë duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që e ka në menaxhim të saj. Regjistri duhet mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Ne identifikuam parregullsitë si në vijim:

- Pasuria kapitale mbi 1,000€ ishte nënvlerësuar për 1,829,886€, pasi që 78 pagesa (ndërtim rrugëve, shpronësime, mirëmbajtje investive etj.) nuk ishin regjistruar në SIMFK;
- 22 vetura të llojeve të ndryshme të cilat janë të vjetra dhe vlera e tyre në libra do duhej të ishte zero, nuk janë zhvlerësuar fare duke mbivlerësuar pasurinë kapitale neto për 70,615€;
- Objekti i shkollës fillore “Edmond Hoxha” nuk i takon Komunës së Deçanit por asaj të Junikut ndërsa ende figuron në regjistrat e pasurisë kapitale duke e mbivlerësuar pasurinë kapitale bruto për 256,660€;
- Pasuria jo kapitale nën 1,000€ ishte nënvlerësuar për 115,209€, pasi që 52 pagesa të realizuara gjatë vitit 2020 për blerjet e mobiljeve dhe pajisjeve nuk ishin regjistruar fare; dhe
- Pronat, ndërtesat dhe objektet tjera në pronësi të komunës ende nuk janë të vlerësuara dhe të regjistruara në regjistrat kontabël.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrollit të brendshëm me ç’ rast informacionet relevante për regjistrimin e drejt të pasurisë nuk qarkullojnë në mënyrë të ndërsjellë në mes të departamentit të financave dhe zyrtarit të pasurisë si dhe mos-funksionalizimit të modulit të zhvlerësimit në sistemin e-pasuria .

Ndikimi

Prezantimi jo i drejtë i pasurive në pasqyra financiare dhe në regjistrat e pasurisë ndikon në vendimet e përdoruesve të informacioneve dhe keq menaxhimin e saj.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të siguroj funksionimin e kontrollit të brendshëm në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë duke vendosur dizajn të kontrolleve në komunikimin ndërmjet zyrtarit të pasurisë në njërën anë dhe departamentit të financave në anën tjetër dhe duke funksionalizuar modulën e zhvlerësimit në sistemin e-pasuria si dhe regjistrimit të plotë të pasurive jokapitale në këtë sistem.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B2 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve****Gjetja**

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 70,000€ në kategori ekonomike jo adekuate, si në vijim:

- Bazuar në vendimin e Kuvendit Komunal të dt.22.04.2020, ishte realizuar pagesa në vlerë 50,000€ ndaj një kompanie publike për mbulim të shpenzimeve të shkaktuara nga pandemia COVID 19. Kjo pagesë ishte realizuar nga kategoria e investimeve kapitale, përderisa këto shpenzime për nga natyra i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe tranfereve; dhe
- Kuvendi i Komunës me dt.20.05.2020 kishte marrë vendim që nga kategoria e investimeve kapitale të paguaj shumën prej 20,000€ për projektin “Vlerësimi ekonomik i ndikimit të pandemisë COVID 19” në ekonomin e Komunës së Deçanit. Sipas natyrës këto shpenzime i takojnë kategorisë mallra dhe shërbimet. Pagesa është bërë me dt.17.06.2021.

Shkaku i një keq-klasifikimi të tillë ishte se këto shpenzime nuk kanë mundur të parashikohen në buxhetin e vitit 2020 si rezultat i pandemisë Covid-19, si dhe kontrolleve të brendshme joefikase.

Ndikimi

Pagesat e realizuara nga kategoria jo-adekuate, rezultojnë me prezantim të gabuara të shpenzimeve në Pasqyrat Financiare. Raportimi jo i drejtë i të dhënave për klasifikimin e shpenzimeve, çorienton shfrytëzuesit e këtyre informatave të prezantuar gabimisht në PFV apo ndikon vendimmarrjen e menaxhmentit.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të siguroj vendosjen e kontrolleve në mënyrë që shpenzimet të planifikohen dhe të klasifikohen drejt komor kategorive të përcaktuara me planin kontabël të SIMFK-së. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e Komunës, duhet të bëhet ridestিনি i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për fuqizimin e kontrollit për planifikimin, pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejt të shpenzimeve publike në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B3 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzimet shtesë të procedurave përmbartimore

Gjetja

Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP, Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbartuesi.

Nga analiza e data bazës së furnitorëve kemi vërejtur se komuna gjatë vitit 2020 kishte kryer pagesa në vlerë prej 1,694,096€ apo 1,375 raste të pagesave të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor. Vonesat variojnë nga 1 deri në 22 muaj.

Po ashtu vlera e nëntë pagesave të realizuara nga Thesari në bazë të vendime gjyqësore/përmbartimore ishte 490,382€, prej tyre borxhi kryesor ishte 455,054€ ndërsa 35,328€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit.

Hyrja në obligime pa buxhet dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mos realizimin e pagesave brenda afatit kohorë ligjor dhe njëherit realizimin e pagesave me vendime gjyqësore/përmbartimore.

Ndikimi

Si pasojë e vonesave të pagesave dhe mungesës së informacioneve të plota, mund të dobësohet aftësia e komunës për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet. Po ashtu, komuna mund të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbartimore.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetoren dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbartimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë

Gjetja

Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11 pika 1 definon: "Zbritja për vendbanimin parësor- Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohe zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000€) nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.

Po ashtu, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë ka njoftuar komunat për vendimin e marr me dt. 16.04.2021 për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, kjo me qëllim të shmangies së duplikimeve/apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni. Për më tepër, regjistrimi i numrave personal rrit eficientë, garanton informata më të sakta dhe të besueshme në regjistrin e tatimit në pronë dhe sjell përfitime të tjera të shumta për tatimpaguesit.

- Tre nga tetë mostrat e testuara, tatimpaguesit që nuk posedonin prona të regjistruara për vendbanim parësor, komuna ju kishte lejuar zbritjen prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e pronës. Po ashtu, nga analiza e data bazës për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se zbritja ishte aplikuar tek 873 prona të cilat nuk ishin të regjistruara si vendbanim parësor. Si rezultat i kësaj, komuna ka ngarkesa tatimore vjetore më të ulëta prej 19,642€.
- Në pesë nga tetë mostrat e testuara ishte aplikuar zbritja për pronat personave që nuk kishin të evidentuar numrin personal. Po ashtu, nga analiza e data bazës për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se 934 personave iu ishte bërë zbritja pa numër personal ku për pasojë rezultoi afërsisht prej 21,015€ më pak të hyra nga kjo kategori. Zyrtarët komunal theksuan se kanë marrë përgjigje nga departamenti i tatimit në pronë në MF se “Ky problem do të vazhdojë të ekzistojë deri sa të plotësohet numri personal për të gjithë tatimpaguesit” dhe tek në vitin 2021 zbritja nuk do të aplikohet për këto raste.

Neglizhenca e zyrtareve kompetent ka ndikuar që gabimet të mos përcjellën tek zyrtarët e nivelit qendror për korrigjimet e nevojshme.

Ndikimi

Vlerësimi i njësive rezidenciale me zbritje pa numër personal, dhe pa deklarim se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me kalkulim të parregullt të zbritjes apo shmangie nga tatimi në pronë, ku për pasojë komuna pranon më pak të hyra nga kjo kategori.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të siguroj bashkëpunim dhe komunikimi më të mirë në mes të Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabimi tjetër eventuale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mospërputhje ndërmjet situacionit të punëve të kryera dhe specifikacionit të kontratës

Gjetja

Sipas Udhëzuesit për prokurimin publik, pika 56 Kontrata Kornizë pika 10-Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqindje (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + 30%, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

Nga testimi i pesë pagesave në shumë totale 728,687€ të projektit “Mirëmbajtje verore dhe dimërore në rrugët e komunës së Deçanit” kemi vërejtur tejkallim të sasisë së kontraktuar dhe asaj të faturuar/paguar.

Tejkallim të sasive kishte në dy pozicione në vlerë totale prej 282,209€:

- Tek pozicioni nr. 4 sasia e kontraktuar ishte 15,000m³ plus 30% tejkallimi i lejuar, gjithsej sasia e lejuar ishte 19,500m³, ndërsa sasia e realizuar ishte 43,554m³. Pra kishte tejkallim për 24,054m³ apo 84,191€.
- Tek pozicioni nr. 6 sasia e kontraktuar ishte 8,500m³ plus 30% tejkallimi i lejuar, gjithsej sasia e lejuar ishte 11,050m³, ndërsa sasia e realizuar ishte 39,338m³. Pra kishte tejkallim për 28,288m³ apo 198,017€. Pra, shuma totale e tejkalluar për këto dy pozicionet është 282,209€.

Sipas ekzaminimit/rishikimit të këtij situacioni dhe librit ndërtimor të organit mbikëqyrës kemi vërejtur se punimet (shtrimi i zhavorrit) ka ndodhur jashtë kontratës në rrugë regjionale që është kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës (MI), për të cilin rrugë Ministria kishte kontratë të nënshkruar për realizimin e këtyre punimeve.

Sipas zyrtarëve komunal përkatësisht menaxherit të kontratës sasitë e tejkaluara janë bërë me njoftimin e kryetarit të komunës. Aprovimi i sasive të tejkaluara është bërë në bazë të punimeve të kryera në një rrugë jashtë qytetit të Deçanit duke arsyetuar se rregullimi i asaj rrugë është prioritet i vet kryetarit dhe kërkesë e banoreve të komunës.

Ndikimi

Mospërputhshmëria ndërmjet situacioneve të punëve të kryera dhe specifikacionit të kontratës krijon paqartësi lidhur me nevojat reale për punë dhe ndikon në zbatimin e drejtë të kontratës sipas kushteve kontraktuale dhe kornizës ligjore të prokurimit publik.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të siguroj përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin e saktë të nevojave për punë dhe zbatimin e drejtë të kornizës ligjore të prokurimit publik. Po ashtu duhet të siguroj se projekti i filluar nuk tejkalon paramasen e përlogaritur si në sasi ashtu edhe në vlerë ashtu siç janë përcaktuar me kushtet e kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Deçanit në 2020 ishin në vlerë prej 409,922€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksa rrugore, participimet, taksat administrative, taksat nga veprimtaritë e biznesit, të hyrat nga lejet e ndërtimit etj. Krahasuar me vitin e kaluar komuna ka një rënie të të hyrave vetjake prej 141,706€ apo shprehur në përqindje përafërsisht 27%. të cilat mbledhen nga niveli qendror (gjobat në trafik, të gjykatave si dhe nga agjencia e pyjeve) në vlerë prej 123,977€. Kemi testuar 5 mostra për teste substanciale në vlerë 31,813€ si dhe tetë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Ankesa të shumta nga qytetarët për vlerësimin e pronave.

Gjetja

Sipas "Ligjit nr. 06/L-005 neni 12, paragrafi 2, çdo komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës. Sipas këtij paragrafi ndër përgjegjësitë e Komunës janë si në vijim: regjistron dhe menaxhon të dhënat e tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë, bashkëpunon me Ministrinë e Financave për vlerësimin e pronave të paluajtshme. Po ashtu sipas nenit 31 pika 6 "Komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë, deri në tridhjetë ditë kalendrike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar me një vendim të arsyetuar".

Lidhur me këtë kemi identifikuar se:

- Nga gjithsej 87 ankesa lidhur me vlerësimin jo të duhur të pronave (62 për prona Banimi, 8 për prona komerciale, 11 prona bujqësorë, 4 dyqane dhe 2 për prona industriale) vetëm 8 prej tyre janë refuzuar ndërsa pjesa tjetër e ankesave janë pranuar si të bazuara. Kjo tregon për nivelin e lartë të gabimeve në bazën e të dhënave.
- Në 75 raste ku tatimpaguesit kanë bërë ankesë lidhur me pasaktësinë e faturës së tatimit në pronë shqyrtimi i tyre ka tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh nga 105 ditë deri në 175ditë.

Kjo ka ndodhur për shkak të komunikimit të pa mjaftueshëm ndërmjet komunës dhe Ministrisë së Financave, stafit të limituar në sektorin e Tatimit në pronë, si dhe kujdesit jo të duhur dhe mos koordinimit ndërmjet komisionit për shqyrtim të ankesave dhe verifikimit të pronës në terren në mënyrë efektive.

Ndikimi

Mos azhurnimin i informatave dhe vlerësimi jo i duhur i pronave në bazën e të dhënave të tatimit në pronë mund të ndikoj në vështirësi në inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë dhe rritjen e llogarive të arkëtueshme si pasojë e pakënaqësisë dhe ankesave të qytetarëve. Ndërsa shqyrtimi i ankesave me vonesë nga autoritetet komunale dëmton imazhin e komunës dhe paraqet shkelje ligjore.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj një koordinim më të mirë ndërmjet komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të të dhënave në bazën e të dhënave. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të siguroj se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për taksapaguesin dhe të sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve nga ana e komisionit përkatës dhe zyrtarëve përgjegjës bëhet brenda afateve ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave

Gjetja Sipas nenin 15 të pikës 2 të Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës.

Nga 8,047 prona të evidentuara në bazën e të dhënave mbi pronë, komuna kishte arritur të verifikoj 196 prej tyre apo 2,4%, po ashtu gjatë vitit 2020 komuna kishte regjistruar edhe 164 prona të reja.

Verifikimi jo i plotë kishte ndodhur për shkak që zyrtarët komunal kishin pasur probleme me lëvizjet për shkak të pandemisë COVID-19.

Ndikimi Verifikimi jo i plotë i pronave për qëllime të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 1,624,548€, prej tyre ishin shpenzuar 1,562,168€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizime për shpenzimet në administratën komunale dhe nevojat e shëndetësisë primare. Kemi testuar 19 mostra për teste substanciale në vlerë 252,093€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A4 - Mangësi në emërim dhe angazhim të zyrtarëve për kryerjen e shërbimeve të veçanta

Gjetja

UA Nr. 01/2018 neni 7, Ligji i punës 03/L-212 neni 10 paragrafi 6 Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë (120) ditë brenda një (1) viti, Ligji për Zyrtares Publik Nr.06/L-114 neni 84 Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik.

Komuna e Deçanit gjatë vitit 2020 me vendime të kryetarit për emërim kishte angazhuar 26 punonjës prej tyre 14 punonjës janë angazhuar në pozita të rregullta të shërbyesve civile si zyrtar të ndryshëm të administratës dhe 12 këshilltar në zyrën e kryetarit. Kohëzgjatja dhe angazhimit të këtyre zyrtarëve ishte lidhur me mandatin e kryetarit pa bazë të qartë ligjore.

Po ashtu me marrëveshje për shërbime të veçanta ishin angazhuar 24 punonjës, prej tyre 14 ishin angazhuar si mësimdhënës në drejtorin e arsimit për një periudhë një vjeçare si dhe 10 mjek në drejtorinë e shëndetësisë për një periudhë 6 mujore me mundësi vazhdimi, angazhimi i tyre kishte filluar pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtares Publik.

Angazhimet me vendime të kryetarit për shërbyes civil, këshilltar dhe MSHV ishin bërë pa zhvilluar ndonjë procedurë të paraparë ligjore.

Sipas zyrtarëve komunal angazhimi i stafit pa procedura ka ndodhur për shkak të gjendjes pandemike COVID-19.

Ndikimi

Emërimi i zyrtareve në pozita të rregullta për periudhë të caktuar dhe angazhimi me kontrata për një detyrë specifike me afat më të gjatë sesa parashihet si dhe këshilltarëve pa procedura është në kundërshtim me legjislacionin përkatës dhe njëherësh rrit rrezikun e angazhimit të stafit jo kompetent për pozita të caktuara

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të prokurimit për angazhimin e stafit për MSHV. Si dhe, të sigurojë se kjo formë e angazhimit aplikohet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur kërkesat janë të arsyeshme nga njësit kërkuuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Pagesa për shërbime/punë pa kontratë**Gjetja**

Sipas nenit 26 të Rregullës Financiare 01/2013, 'Asnjë detyrim për pagesë nuk zbatohet nëse për të njëjtin nuk ekziston një dokument, marrëveshje apo aranzhim në bazë të cilit rezulton lindja e atij detyrimi'.

Në dy raste janë realizuar pagesa pa kontratë për kryerjen e shërbimeve për rregullimin e sallës së teatrit "Jusuf Gërvalla" në Deçan në vlerë total 13,455€. Gjithashtu faturat nuk përmbanin sasinë dhe çmimet e shërbimeve të kryera por vetëm vlerën totale, si në vijim:

- Pagesa në vlerë 9,195€ e dt.19.02.2020 për pastrimin dhe dezinfektimin e sallës në vlerë 1,830€, rregullimi dhe dekorimi i binës në vlerë 2,745€ dhe mbyllja e disa vrimave në qati dhe gëlqerosja e mureve në vlerë 4,620€.
- Pagesa në vlerë 4,260€ e dt.23.01.2020 për Pastrimi dhe dezinfektimi i sallës së teatrit për dy ditë, molerimi i mureve të sallës, ndërrimi i perdeve dhe izolimi i dritareve të teatrit në bazë të kërkesës nga KK Deçan.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase me rastin ekzekutimit të pagesave.

Ndikimi

Kryerja e shërbimeve punëve pa kontratë rrit rrezikun që cilësia dhe çmimi i shërbimeve/punëve të mos jenë komfor kushteve të tregut dhe njëherësh mund të ndikojë në dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të ndërmarrë masa që asnjë pagesë të mos kryhet pa kontratë valide. Po ashtu të siguroj se faturat e paguara përmbajnë informatat për sasinë dhe çmimet e shërbimeve të kryera.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 141,456€, prej tyre ishin shpenzuar 115,821€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencione për entitete jopublike si: financimi i klubeve sportive, shoqatave kulturore. Kemi testuar 5 mostra për teste substanciale në vlerë 28,620€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A5 - Dobësi në financimin e OJQ-ve me subvencione

Gjetja

Rregullorja Nr. 04/2017, neni 1 përcakton kriteret, standardet dhe procedurat themelore për financimin publik të organizatave jo-qeveritare (këtu e tutje OJQ), me qëllim të vendosjes së një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financimin me fonde publike të programeve dhe projekteve të OJQ-ve që janë të interesit publik të në Republikën e Kosovës.

Po ashtu sipas nenit 12, çdo mbështetje financiare për OJQ-të duhet të shpallet me thirrje publike, e cila duhet të publikohet në ueb faqen e ofruesit të mbështetjes financiare.

Në katër nga 10 mostrat e testuara me vendim të Kuvendit Komunal janë ndarë subvencione në vlerë totale 18,820€ për katër OJQ pa thirrje publike. Për më tepër komuna nuk kishte lidhur/nënshkruar ndonjë marrëveshje me përfituesit e subvencioneve ku do të cekej mënyra e shfrytëzimit të mjeteve, raportimi dhe monitorimi.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi

Ndarja e subvencioneve pa thirrje publike ndikon në transparencë dhe në uljen e konkurrencës, po ashtu mos nënshkrimi i marrëveshjeve/kontratave me përfituesit e subvencioneve rrit rrezikun që mjetet buxhetore të ndahen dhe shpenzohen në kundërshtim me objektivat e Komunës.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të siguroj që subvencionimi i OJQ-ve bëhet përmes thirrjes publike siç përcaktohet me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve. Po ashtu me rastin e ndarjes së subvencioneve të lidhë marrëveshje me përfituesit për tu siguruar se mjetet shpenzohen për objektivat e përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 16,794,969€, pasurive jokapitale është 80,342€ ndërsa komuna nuk mban stoqe. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale për pasurinë kapitale në vlerë 1,702,768€. Në pasuri jokapitale ne kemi përdorur procedura analitike krahasuese dhe substanciale për qëllimin e saktësisë.

Çështja B6 - Mangësi në procesin e inventarizimit të pasurisë jo financiare

Gjetja Sipas nenit 3 të Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare - ZKA formon komisionin për inventarizimin e pasurisë jo financiare në OB me qëllim të inventarizimit vjetor apo periodik të pasurisë jo financiare. • Po ashtu, sipas nenit 19 pika 4.3 të rregullores së njëjtë - Përgjegjësitë e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është edhe – Krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurisë jo financiare.

Komuna kishte formuar komisionin e inventarizimit i cili e kishte përgatitur raportin për inventarizimin e pasurisë. Megjithatë komisioni përgjegjës nuk kishte harmonizuar gjendjen e inventarizimit me gjendjen e pasurisë në regjistra kontabël.

Kjo gjendje ka ndodhur si rezultat i mos komunikimit të ndërsjellët ndërmjet zyrtarëve kompetent.

Ndikimi Mos harmonizimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël rrit rrezikun që pasuritë të keqpërdorën, humben apo të tjetërsohen, si dhe vlera e pasurisë së organizatës e pasqyruar në PFV të mos jetë e drejtë.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë se puna e komisionit të inventarizimit është kryer me përgjegjësi të plot dhe para përpilimit të PFV për vitin 2021. Implementimi i këtij procesi duhet të reflektojë me krahasimin ndërmjet inventarizimit dhe gjendjes së pasurisë të mbajtur në regjistrat kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2020, ishte 195,527€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2021. Po ashtu komuna kishte shpalosur detyrimeve kontingjente në vlerë 495,467€.

Çështja A6 - Mos prezantim i plote i detyrimeve kontingjente

Gjetja Neni 18 i Raportit Vjetor Financiar për Organizatat Buxhetore parasheh prezantimin e detyrimeve kontingjente dhe shpalosjen në detaje të shënimeve në tabelë.

Bazuar në dëshmitë e ofruara nga komuna vlera e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2020 duhet të ishte se paku prej 1,971,917€, për derisa komuna në PFV kishte shpalosur vetëm 495,467€ detyrime kontingjente. Vlera e detyrimeve kontingjente e prezantuar në PVF është nënvlerësuar për 1,476,450€.

Kjo ka ndodhur si pasoj e mos komunikimit të ndërsjellët të zyrës ligjore dhe zyrës së financave.

Ndikimi Mungesa e prezantimit të plotë të detyrimeve kontingjente (padive gjyqësore) që janë në proces të shqyrtimit (aktive) shkakton nënvlerësim të tyre dhe për pasoj mos planifikimin e duhur të buxhetit për mbulimin e detyrimeve financiare në rast të humbjes së këtyre kontesteve.

Rekomandimi A6 Kryetari të siguroj që detyrimet kontingjente janë prezantuar drejtë në PFV. Duhet të sigurohen të dhënat e sakta dhe të plota mbi këto detyrime nga zyra ligjore dhe të njëjtat të përcillen në zyrën e financave si hartuese të PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm (NJAB) operon me dy anëtar – Drejtori i NJAB-së dhe një zyrtar. Kjo njësi për vitin 2020 kishte planifikuar kryerjen e pesë auditimeve, deri në fund të vitit kishte finalizuar pesë raporte si dhe kishte bërë një rishikim për të verifikuar adresimin e rekomandimeve

Çështja B7 - Mungesa e planeve të veprimit në adresimin e rekomandimeve të NJAB-ë

Gjetja Sipas Rregullores 01/2019 për Themelimin dhe zbatimin e auditimit të brendshëm neni 9, pika 7 - Auditorët e brendshëm monitorojnë zbatimin e rekomandimeve në mënyrë sistematike sipas planit të veprimit të miratuar nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik. Gjithashtu sipas nenit 10 pika 1.3 të së njëjtës rregulloreje - Është përgjegjësi e udhëheqësit të subjektit të sektorit publik për auditimin e brendshëm për të siguruar zbatimin e rekomandimeve për të cilat janë pajtuar për auditimin e brendshëm sipas planit të veprimit.

Njësitë e audituara nuk kishin përgatitur plane veprimi për adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të brendshëm. Si rrjedhojë, rekomandimet e AB-së nuk ishin adresuar sa duhet nga menaxhmenti, ku 11 nga 32 rekomandimet e dhëna për vitin 2020 nuk ishin adresuar.

Kjo ka ndodhur nga neglizhenca dhe mos përgjegjësi e zyrtareve përgjegjës të drejtorive përkatës

Ndikimi Mungesa e planit të veprimit dhe ndërmarrja e veprimeve të pamjaftueshme nga menaxhmenti në adresimin e rekomandimeve mund të rezultojë me vazhdimin e dobësive të identifikuara, jo efikasitet në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurojë përgatitjen e planeve të veprimit nga njësitë e audituara për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe njëherësh të sigurojë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga AB-ja.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^a	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	9,731,597.00	10,246,536.22	9,845,910.90	8,782,569.43	7,918,283.97
Grante Qeveritare – Buxheti	8,961,331.00	9,129,951.46	9,090,915.10	7,926,709.36	7,607,137.46
Financimi përmes huamarrjes	0.00	101,785.00	91,160.50	53,207.10	5,380.00
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	242,102.23	241,945.68	332,897.76	19,078.48
Të hyrat vetanake	770,266.00	770,266.00	421,889.62	461,547.27	277,109.43
Donacionet vendore	0.00	2,379.90	0.00	0.00	9,578.60
Donacionet e jashtme	0.00	51.63	0.00	8,207.94	0.00

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 514,940€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak, rritjes së grantit qeveritar, donacioneve dhe financimit nga huamarrja.

Në vitin 2020 Komuna e Deçanit ka shpenzuar 96% të buxhetit përfundimtar, ose 9,845,911€. Në krahasim me vitin 2019 kemi përafërsisht nivel të njëjtë të realizimit të buxhetit final (2019-95%). Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	9,731,597.00	10,246,536.22	9,845,910.90	8,782,569.43	7,918,283.97
Pagat dhe mëditjet	5,416,006.00	5,539,793.14	5,533,457.64	5,266,808.78	5,260,346.81
Mallrat dhe shërbimet	1,365,474.00	1,624,548.49	1,562,168.30	1,156,447.06	875,428.19
Komunalit	155,000.00	155,000.00	154,999.89	155,258.53	105,324.88
Subvencionet dhe transferet	140,000.00	141,456.26	115,821.18	89,342.60	84,628.48
Investimet Kapitale	1,972,668.00	2,785,738.33	2,479,463.89	2,114,712.46	1,592,555.61
Rezervat	682,449.00	0.00	0.00	0.00	0.00


- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 123,788€ si rezultat i rishikim të buxhetit për arsye të angazhimit të stafit për pandeminë Covid -19, buxheti final ishte shpenzuar 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 259,074€, si rezultat i rishikim të buxhetit, ky buxhet ishte shpenzuar 96%;
- Buxheti fillestar me buxhetin final të kategoritë e subvencioneve, nuk kishte ndonjë ndryshim të domethënës i cili ishte shpenzuar në masën prej 82%, ndërsa për kategorinë komunalive nuk ka ndryshime fare; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 813,070€, dhe me një shpenzim efektiv prej 89% të buxhetit të shpenzimeve kapitale gjatë vitit.

Komuna për menaxhimin e pandemisë Covid-19 kishte shpenzuar buxhet në vlerë prej 284,596€, prej tyre 235,357€ ishin për shtesa në paga si dhe 49,239€ mallra dhe shërbime.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Deçanit në 2020 ishin në vlerë prej 409,922€. Krahasuar me vitin e kaluar komuna ka një rënie të hyrave vetjake prej 141,706€ apo shprehur në përqindje përafërsisht 27%. Po ashtu komuna ka inkasuar edhe të hyra indirekte të cilat mbledhen nga niveli qendror (gjobat në trafik, të gjykatave si dhe nga agjencia e pyjeve) në vlerë prej 123.977€

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	770,266.00	770,266.00	409,921.75	551,627.53	450,364.40
Të hyrat tatimore	399,805.00	399,805.00	232,312.25	279,040.85	197,772.60
Të hyrat jo tatimore	370,461.00	370,461.00	177,609.50	272,586.68	252,591.80

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunës së Deçanit ka rezultuar në 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Komuna e Deçanit ka hartuar Raportet periodike për ecurinë e rekomandimeve të ZKA për vitin 2019.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, gjashtë rekomandime janë zbatuar dhe shtatë rekomandime nuk janë adresuar ende si dhe një nuk është i aplikueshëm.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj një koordinim më të mirë ndërmjet komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të të dhënave në bazën e të dhënave. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të siguroj se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për taksapaguesin dhe të sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve nga ana e komisionit përkatës dhe zyrtarëve përgjegjës bëhet brenda afateve ligjore.	Nuk janë ndërmarra veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të personelit se proceset e rekrutimit zhvillohen në pajtim të plotë me procedurat dhe rregullat e rekrutimit, dhe në rast të mungesës së tre kandidatëve të përgjegjshëm të rishpallet konkursi. Po ashtu, duhet të shtojë masat e sigurisë lidhur me qasjen në dokumente/testet për kandidatë.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
3.	Mallrat dhe shërbimet Komunalit	Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të thjeshtuara të rekrutimit të stafit për MSHV. Si dhe të sigurojë se kjo formë e angazhimit aplikohet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur kërkesat janë të arsyeshme nga njësitë kërkuese.	E rregulluar me aplikimin e procedurave të prokurimit për angazhimin e stafit për MSHV.	Nuk është i aplikueshëm më
4.	Mallrat dhe shërbimet Komunalit	Kryetari duhet të siguroj se njësitë kërkuese planifikojnë saktë dhe se bazohen në nevojat reale, me qëllim të menaxhimit efikas të kontratës.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet Komunalit	Kryetari duhet të siguroj se për çdo shpenzim për të cilin kërkohet proces i tenderimit duhet të zhvillohen procedura të prokurimit komfor kritereve të përcaktuara ligjore, në të kundërtën furnizimet e pa kontraktuara duhet të ndërpriten.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur rastet e tilla.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherëve të kontratave se nuk kryhet asnjë pagesë për punët të cilat nuk janë përfunduar. Po ashtu, duhet të sigurojë se kontratat përfundojnë sipas planit, në të kundërtën për çdo vonesë të paarsyeshme të aplikohen penalet për ditët në vonesë.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur rastet e tilla.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin e saktë të nevojave për punë dhe zbatimin e drejtë të kornizës ligjore të prokurimit publik.	Nuk janë ndërmarra veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin

8.	Investimet kapitale	Kryetari të siguroj vendosjen e kontrolleve në mënyrë që shpenzimet të planifikohen dhe të klasifikohen drejtë komfor kodeve ekonomike të përcaktuara me planin kontabël të SIMFK-së.	Nuk ndërmarrë veprime të nevojshme.	janë të	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Çështjet përbashkëta	Kryetari të siguroj një planifikim të drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet duke respektuar afatet kohore të përcaktuara me LMFP.	Nuk ndërmarrë veprime të nevojshme.	janë të	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj funksionimin e kontrollit të brendshëm në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë duke vendosur dizajn të kontrolleve në komunikimin ndërmjet zyrtarit të pasurisë në njërin anë dhe departamentit të financave në anën tjetër dhe duke funksionalizuar modulën e zhvlerësimit në sistemin e pasurisë si dhe regjistrimit të plotë të pasurive jokatitale në këtë sistem.	Nuk ndërmarrë veprime të nevojshme.	janë të	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Pasuritë	Kryetari i duhet të siguroj hartimin e udhëzuesit të brendshëm të inventarizimit pastaj të formoj komisionin e inventarizimit të pasurisë jo financiare me mandat të qartë dhe se raporti përfundimtarë i inventarizimit duhet të bëhet para përgatitjes së pasqyrave financiare duke i krahasuar shënimet me regjistrat e pasurisë financiare.	Nuk ndërmarrë veprime të nevojshme.	janë të	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Llogaritë arkëtueshme	Kryetari komunës duhet të siguroj se ndërmerr masa në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme sipas ligjit mbi tatimin në pronë, sipas kontratave për pasuritë e dhëna në shfrytëzim, dhe duke përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbartësve. Gjithashtu duhet shtohen kontrollet që kjo llogari të prezantohet drejt në PFV.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	e	zbatuar
13.	Obligimet papaguara	Kryetari të siguroj ndërmarrjen e masave për përmirësimin e mekanizmave të brendshme të kontrollit lidhur me respektimin e kriterëve ligjore për raportim të rregullt të obligimeve financiare në MF-Thesar.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur rastet e tilla.	e	zbatuar
14.	Auditimi Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë përgatitjen e planeve të veprimit nga njësitë e audituara për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.	Nuk ndërmarrë veprime të nevojshme.	janë të	Nuk ka filluar zbatimin

Nr.	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për konkluzion	Kryetari i Komunës duhet të siguroj bashkëpunim dhe komunikim më të mirë në mes të Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabim tjetër eventual.
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në

		mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj një koordinim më të mirë ndërmjet komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të të dhënave në bazën e të dhënave. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të siguroj se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për taksapaguesin dhe të sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve nga ana e komisionit përkatës dhe zyrtarëve përgjegjës bëhet brenda afateve ligjore.
4.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalit	Kryetari të siguroj që të realizohen vetëm shërbimet/mallrat/furnizimet apo punët që janë të parapara në kontratë.
5.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalit	Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të prokurimit për angazhimin e stafit për MSHV. Si dhe, të sigurojë se kjo formë e angazhimit aplikohet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur kërkesat janë të arsyeshme nga njësit kërkuese.
6.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që subvencionimi i OJQ-ve bëhet përmes thirrjes publike siç përcaktohet me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve. Po ashtu me rastin e ndarjes së subvencioneve të lidhë marrëveshje me përfituesit për tu siguruar se mjetet shpenzohen për objektivat e përcaktuara.
7.	Investimet kapitale	Kryetari i Komunës duhet të siguroj përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin e saktë të nevojave për punë dhe zbatimin e drejtë të kornizës ligjore të prokurimit publik. Po ashtu duhet të siguroj se projekti i filluar nuk tejkalon paramasen e përlllogaritur si në sasi ashtu edhe në vlerë ashtu siç janë përcaktuar me kushtet e kontratës.
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj vendosjen e kontrolleve në mënyrë që shpenzimet të planifikohen dhe të klasifikohen drejtë komfor kategorive të përcaktuara me planin kontabël të SIMFK-së. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e Komunës, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për fuqizimin e kontrollit për planifikimin, pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejt të shpenzimeve publike në PFV.
9.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj funksionimin e kontrollit të brendshëm në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë duke vendosur dizajn të kontrolleve në komunikimin ndërmjet zyrtarit të pasurisë në njërën anë dhe departamentit të financave në anën tjetër dhe duke funksionalizuar modulën e zhvlerësimit në sistemin e-pasuria si dhe regjistrimit e plotë të pasurive jokapitale në këtë sistem.
10.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se puna e komisionit të inventarizimit të është kryer me përgjegjësi të plotë dhe para përpilimit të PFV për vitin 2021. Implementimi i këtij procesi duhet të reflektoj me krahasimin ndërmjet inventarizimit dhe gjendjes së pasurisë të mbajtur në regjistrat kontabël.
11.	Obligimet e papaguara	Kryetari të siguroj që detyrimet kontingjente janë prezantuar drejtë në PFV. Duhet të sigurohen të dhënat e sakta dhe të plota mbi këto detyrime nga zyra ligjore dhe të njëjtat të përcillen në zyrën e financave si hartuese të PFV.
12.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetoren dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.
13.	Auditimi Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë përgatitjen e planeve të veprimit nga njësitë e audituara për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm




Arian Haxha, Udhëheqës i Auditimit



Kapllan Muhaxheri, Udhëheqës i ekipit



Mehmet Kurti, Anëtar i ekipit



Hysen Boqolli, Anëtar i ekipit



Florim Maliqi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,


Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Komunës së Deçanit**, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Zyrtar Kryesor Administrativ

Bashkim Ramosaj

Data: 22 korrik 2021



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.¹⁰ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç 'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ [*]Vonesat variojnë nga një muaj deri në dy vite
- ⁶ [*] Pagesa në shumë prej 285,000€ dt.05.10.2020, Pagesa 100,000€ dt.06.08.2020, Pagesa 69,027 dt.13.07.2020, Pagesa 104,457 dt.03.11.2020 dhe Pagesa në shume 170,204€ dt.23.10.2020. Kontrata kornize me OE "Lika Trade" ishte lidhur me datën 26.06.2020 deri më 26.06.2023 në shumë prej 1,933,111€
- ⁷ [*]KF"Deçan" në vlerë 5,000€, KF"Jusfu Gërvalla" në vlerë 5,000€, Shoqata e bjeshkataveve alpiniste në vlerë 5,620€ dhe KF"Besa" në vlerë 3,200€.
- ⁸ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁹ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹⁰ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.